



			
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA FANCLARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRAPARR DOREZUAR: DATUM PRIFILJE DOSTAVLJENI: DATE RECEIVED SUBMITTED:			
Thema Org Org Jedm Org Unit	Shif. Klasif Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Tir. rrezeve Br. Stranica No. Pages
04 Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo		1638	20



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

- Plani i Veprimit i Menaxhmentit -

Për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2019

Nr.	Kategoria	Komponenta e Auditimit (të gjeturat)	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit (Drejtorisë)	Data planifikuar për përfundim	Drejtorja/Zyrtari përgjegjës
1	A1	Neni 1 i Rregullores Nr 01-463/01-0253544117, i miratuar me datën 10.10.2017, për aplikimin e tatimit në pronë në Komunën e Prishtinës e ka përcaktuar në dhjetë zona të qytetit. Nga testimi i gjashtë faturave në vlerë prej 1,437€ kemi gjetur se nuk janë përdorur zonat adekuate të përcaktuara me rregullore. Kjo ka ndikuar që të mbi vlerësohet tatimi në pronë në vlerë 596€. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos azhurnimit të gjendjes aktuale në teren për aplikimin e tatimit në pronë në pajtueshmëri me Rregulloren e re dhe mos inspektimet e sakta nga vlerësuesit në teren, kur ata e bëjnë incizimin e objektit me iPad mund të ndodhin gabime teknike dhe prona të regjistrohesh në zonën e gabushme.	Kryetari duhet të sigurojë që vlerësuesit bëjnë inspektimet e sakta të gjendjes në terren në mënyrë që ngarkesat tatimore të bëhen në përputhje me dhjetë zonat e qytetit të përcaktuara në rregulloren e tatimit në pronë.	Menaxhmenti ka planin e punës dhe kemi të parapare që të verifikohen 22000 objekte. Ekipet e terrenit, janë në teren çdo ditë duke bërë inspektimin në teren duke rishikuar se a janë të gjitha objektet e ngarkuar me zonat tatimore sipas Rregullores Nr 01-463/01-0253544117, i miratuar me datën 10.10.2017, dhe atë për periudhën tatimore deri 2019. Ndërsa për vitin tatimor 2020, zonat e vlerave për kategorinë e pronës rezidenciale, të territorit të Prishtinës janë të caktuara sipas raportit Nr 378 dt.31.10.2019, të lëshuar nga Ministria e Financave, në përputhshmëri me 17 paragrafi 1 i Ligjit NR.06/L-005 për TP	Dhjetor 2020	Shemsedin Thaqi

Zyra e Kryetarit të Komunës
Tel. + 381 (0) 230 900; e-mail: Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

2	A2	<p>Neni 16 i Udhëzimit Administrativ 03/2011-“Mbi regjistrimin e pronës”, thotë: “Të gjitha objektet e papërfunduara duhet të tatimohen me 40% të vlerës së tregut të objekteve të banimit dhe në llogaritjen e tatimit nuk do të përfshihet zbritja prej 10,000€ shkalla e amortizimit dhe cilësia e ndërtimit, si dhe për ndërtimet e reja deri në pesë vite duhet të llogariten me normë të kualitetit 1.1 e shkëlqyer dhe të jetë 100% e kompletuar”. Nga 15 mostra të testuara në kemi vërejtur se në 2 raste nga totali i mostrave pronat e papërfunduara janë vlerësuar me normë të kualitetit të ndërtimit 1.1-shkëlqyeshëm dhe kjo pastaj ka rritur shumën e tatimit të vlerësuar. Në rastin tonë shuma e mbivlerësuar për dy mostrat është rreth 2,040€, duke i faturuar më tepër tatimpaguesit. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos verifikimit sistematik të objekteve në teren nga ana e vlerësuesve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që në mënyrë sistematike bëhet verifikimi i objekteve në teren, në mënyrë që pronat të vlerësohen dhe faturohen saktë</p>	<p>Kemi filluar të ndërmarrim veprime sipas rekomandimeve të auditorit. Kemi nxjerrë të dhënat nga regjistri i tatimit në pronë dhe ju është dërguar lista e pronave të papërfunduara zyrtarëve përgjegjës të terrenit që të identifikojnë të gjitha objektet e papërfunduara dhe të njekohësisht të ngarkojnë objektin me tatim në pronë sipas ligjit dhe rregullativës në fuqi për TP.</p>	Dhjetor 2020	Shemsedin Thaqi
3	A3	<p>Neni 17 (pika 1.2) i Ligjit të Ndërtimit me Nr. 04/L-110 thotë: “Izbori i komitetit të ekspertëve të organit kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që janë duke u respektuar afatet ligjore me rastin e lëshimit të lejeve të ndërtimit, kur kërkesat janë plotësuar nga</p>	<p>Për qëllim të implementimit të këtij rekomandimi Drejtoria e Urbanizimit ka huazuar 5 punonjës nga sektori i legalizimit që të ndihmojnë në arritjen e zbatimit të afateve ligjore.</p>	Janar 2021	Shpend Ahmeti Ardian Olluri

		<p>për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III. Nga lestimi 15 lejeve të ndërtimit, në 10 raste ka vonesa në lëshimin e lejeve brenda afatit ligjor, prej një muaj e deri me 16 muaj vonesa. Po ashtu, numri i madh i kërkesave për leje të ndërtimit dhe mos mbajtja e lëndëve në mënyrë të organizuar sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH me Nr. 06-2917- "Për përcaktimin e procedurave mbi përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve -Aneksi 2 ", ku përcaktohen kërkesat për kushte ndërtimor, dokumentacioni dhe mënyra e kompletimit të lëndës, nga ana e zyrtarëve shkaktojnë vonesa në kompletimin e dokumentacionit dhe vonesa në lëshimin e lejeve të ndërtimit.</p>	<p>organet kompetente që kanë bërë kërkesën për lejen ndërtimore.</p>	<p>Drejtoria e Urbanizimit do të hartojë një raport mujor dhe do të përcjellet nga Menaxhmenti.</p>		
4	A4	<p>Rregulla dhe Udhëzuesi operativ i prokurimit publik, përkatësisht pika 61 – Menaxhimi i kontratës, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të Kontratës (MK) në menaxhimin e kontratave publike. MK duhet të sigurojnë se Kontrata po realizohet në përputhje me kushtet kontraktuale. Po ashtu, në kontratën e lidhur me Trafikun Urban për ofrimin e shërbimeve të transportit publik, obligimet mujore</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke siguruar informacion të saktë dhe të mjaftueshëm rreth implementimit të kontratave.</p>	<p>Takim të përbashkët menaxhmeti i komunës me menaxheret e kontratave. Do të këtë koordinim mujor Zyra e Prokurimit me DIKMK, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria PSZHQ, Administratës dhe DSHP. Organi mbikëqyrës do të kërkojë nga kontraktuesi dokument që vërteton/dëshmon të hyrat mujore (raport fiskal apo deklaratë mujore të</p>	Dhjetor 2020	<p>Shpend Ahmeti Medina Braha Shpresa Shala Muhedin Nushi Vasilika Zotaj Genc Bashota</p>

	<p>të komunës ndaj kontraktuesit kalkuloheh sipas formulës: kilometrat mujore të kaluara x çmimi i kontraktuar ~ të hyrat mujore të realizuara nga kontraktuesi. Lidhur me menaxhimin e kontratave publike, ne kemi identifikuar mangësi si në vijim: • Në dy6 kontrata publike kornizë, drejtorët e shkollave dhe menaxheri i kontratave kishin pranuar shërbimet e pastrimit për muajt Mars dhe Dhjetor në vlerë 77,606€ pa u përfunduar muaji. Vlen të theksohet, se një muaj pas nënshkrimit të kontratës për Pastrimin e objekteve shkollore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Naim Frashëri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevari, zyra e prokurimit kishte amendamentuar kontratën dhe kishte rekomanduar rritjen prej 4% të pagës për 83 punonjësit e kompanisë të kontraktuar për mirëmbajtjen e objekteve shkollore në vlerë mujore prej 1,079,30€. Sipas këtij amendamenti, kjo rritje do të përfshinte periudhën nga data 01.01.2018 deri 30.11.2019 në vlerë totale prej 24,824€. Për muajt vijues pagesa shtesë mujore ndaj kryesit të shërbimeve do të jetë çmimi i kontraktuar 32,291€ plus shtesa 1,079€. Në pagesën e shërbimeve të pastrimit të muajit dhjetor pagesa mujore e kontraktuar ishte rritur</p>		<p>raportimit në ATK) dhe dëshmi për km e kaluar para se të procedojë pagesën e faturës mujore.</p>		
--	--	--	---	--	--

		edhe për 4% në emër të rritjes së pagave për punëtorët e operatorit ekonomik të kontraktuar; dhe • Te "Shërbimet e transportit publik në Komunën e Prishtinës" - Menaxherët e kontratave nuk kishin arritur të sigurojnë dëshmi të mjaftueshme për të hyrat mujore të realizuara nga shërbimet e transportit publik për të mbështetur kompensimin e pjesës së mbetur apo obligimin mujor të Komunës ndaj kontraktuesit. Kontraktuesi kishte dorëzuar një raport përshkrues rreth kilometrave të kaluara dhe të hyrave mujore të arkëtuar por pa ndonjë dokument që vërteton/dëshmon të hyrat mujore (Raport fiskal apo deklaratë mujore të raportimit në ATK). Kjo ka ndodhur për arsye të kontrolleve jo adekuate dhe mbikëqyrjen e pamjaftueshme në menaxhimin e kontratave				
5	A5	Rregullorja MF Nr.04/2017 për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 - ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, Po me këtë rregullore, gjithashtu kërkohet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitja e Planit Vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të bëhet brenda afatit të kërkuar me rregullore. Njëherit, të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve nga komisionet bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim gjatë procesit përzgjedhës duke siguruar më tutje monitorim të	Të gjitha drejtoritë të cilat japin subvencione deri me 30 tetor 2020 do të hartojnë Planin Vjetor të mbështetjes financiare për OJQ dhe do të dërgohet në Zyren e Kryeministrit. Cdo komisioni për ndarjen e subvencioneve do t'i kërkojë t'i plotësojë të gjitha kriteret sipas thirrjes publike që është bërë.	Tetor 2020	Shpend Ahmeti Bleria Basholli Shpresa Shala Bujar Gashi Dren Kukaj Fitim Rexha Shkumbin Gashi

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel: +381 (0) 230 900; e-mail: Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

		<p>që përfituesit e subvencioneve të raportojnë dhe të dorëzojnë raporte narrative dhe financiare për projektet e realizuara. Nga ekzaminimi i mostrave të përzgjedhura për auditim, kemi identifikuar se: • Nuk është përgatitur Plani Vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të; • Në 6 raste në vlerë 54,265€, përfituesit e subvencioneve nuk kishin ofruar dëshmi se nuk kanë obligime tatimore dhe se nuk janë në procedura të falimentimit. Kjo ishte kërkesë e përcaktuar me Thirrjen Publike për Subvencionim, e të cilin komisioni nuk e kishin respektuar gjatë procesit si rezultat i kontrollit jo të mirë; dhe • Në një rast në vlerë 11,112€, përfituesi i subvencionit nuk kishte dorëzuar raport narrativ dhe financiar rreth realizimit të projektit, kjo për faktin që nuk është monitoruar nga zyrtarët përgjegjës</p>	vazhdueshëm për projektet e financuara.			
6	A6	<p>Me Rregullën dhe Udhëzuesin operativ të prokurimit publik përcaktohet se një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit, si dhe një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit. Te kontrata "Ndërtimi i rrugëve në</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se do të ketë ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që zyrtarët që i kanë përgatitur termat e referencës/specifikimet teknike të mos të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave.</p>	<p>Të gjitha drejtoritë do të kenë një kontrollë para se të propozojnë zyrtaret për përcaktimin e tyre si Menaxher të Kontratave, dhe të sigurohen që nuk kanë qenë pjesë e vlerëimit apo e hartimit të specifikacioneve të atij projekti.</p>	<p>Korrik-Dhjetor 2020</p>	<p>Shpend Ahmeti Drejtor e drejtorive Zyra e Prokurimit</p>

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel : 381 (0) 230 9100. e-mail: Shpend.Ahmeti@rks.gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

		lagjen Bushgega dhe Geci, Marevc dhe Prapashticë lloti i 1" me vlerë të kontratës 350,485€, kemi vërejtur se zyrtari përgjegjës që kishte hartuar specifikat teknike kishte marrë pjesë në komisionin për vlerësimin të ofertave. Shkaku i ndodhjes së kësaj ishte kujdesi i duhur i zyrtarëve përgjegjës për të eliminuar situatën e tillë.				
7	A7	Sipas UA Nr. 1/2014, si dhe Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) - "Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë", autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit dhe nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Në lidhje me këtë, ne kemi vërejtur se komuna kishte nënshkruar 22 kontrata për punë, në mungesë të projekte ekzekutive. Shkaku i ndodhjes së kësaj sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e një kontrate me ndonjë operator ekonomik për hartimin e projekteve.	Kryetari të siguroj kontrollin dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë të hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara	Për vitin 2020 në kuadër të DIKMK janë paraparë dy kode buxhetore: Hartimi i projekteve për infrastrukturë rrugore 120.000 Euro dhe projektme për ndërtim të lartë 100.000 euro.	Nëntor 2020	Shpend Ahmeti Gëzim Mehmeti
8	A8	Sipas kushteve të veçanta të kontratës së nënshkruar mes operatorit ekonomik dhe autoriteti kontraktues kërkohet që kontraktuesi pasi të përfundoj projektin t'i ofrojë komunës garancinë për 3 vite, në rast të	Kryetari i komunës duhet të sigurojë se pasi të përfundohet projekti është pranuar garancioni për punët e kryera nga ana e operatorit ekonomik ashtu	Të gjithë menaxheret e kontratave do të njoftohen që e kanë obligim ligjor që cdo OE me rastin e nënshkrimit të kontratës të ofrojnë garancionin për 3 vitë sic kërkohet në LPP.	Dhjetor 2020	Shpend Ahmeti Zyra e prokurimit Menaxheret e Kontratave

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. +381 (0) 230 900; e-mail: Shpend.Ahmeti@arks-gov.net

Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

		<p>mekanizma për arkëtimin e llogarive të arkëtueshmet. Kritja e të arkëtueshmeve ndaj komunës, në fund të vitit 2019 ishin 50,520,193€.</p> <p>Sfida kryesor mbetet në inkasimin e tatimit në pronë në vlerë prej 34,558,800€7 , të hyrat nga lejet e ndërtimit në vlerë 5,809,125€ dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 4,417,189€. Si pasojë e mos veprimit të mekanizmave adekuat nga ana e komunës për t'i arkëtuar këto të hyra, shuma e llogarive të arkëtueshme është rritur për 5,402,536€ apo 12% në krahasim me vitin 2018. Në raport me vitin e kaluar, rritja e të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë ishte në shumë prej 2,495,462€, nga të hyrat për mbledhjen e mbeturinave në vlerë 2,099,869€ sepse rreth 24,000 amvisni faturohen dhe fare nuk paguajnë.</p>	<p>arkëtimin e borxheve duke i shfrytëzuar të gjitha masat në dispozicion, si dhe masat ligjore për të mbledhur këto borxhe, të cilat po i shkaktajnë humbje financiare komunës prej vitit në vit.</p>	<p>vazhdojë të përditësojë të dhënat duke u bazuar në kërkesat për ndryshime të adresave etj. që vijnë nga qytetarët. Të njëjtat, në bashkëpunim me zyrtarë të IT-së, futen në sistemin elektronik. Është bërë kërkesë për kushtëzimin e pagesave tjera, përveç tatimit në pronë, me pagesën e taksës për mbeturina në mënyrë që të rritet arkëtimi nga taksat për mbeturina.</p> <p>Në drejtorin e Financave është bërë klasifikimi i borxhlinjeve të mëdhenjë dhe sipas ligjit në fuqi me kalimin e gjendjes së Pandemisë në vend do të fillohet me urdhera përmbarimor në vend, për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme në vend.</p>		<p>Valbona Makolli Medina Braha Ardian Olluri Gëzim Mehmeti</p>
22	CI	<p>Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, neni 12, dhe Ligji i Punës, neni 10, i rregullojnë çështjet e angazhimeve të punonjësve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV). Afati maksimal për MSHV është 6 muaj. Siç është prezantuar në PFV për vitin 2019, Komuna e Prishtinës kishte të angazhuar 176 punonjës me MSHV me orar të plotë dhe 34 punonjës me orar të shkurtër (nga një ditë deri në dy muaj). Angazhimet e tyre ishin bërë për periudha të ndryshme, që nga 1 ditë</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për pozita të rregullta dhe afatgjata të punës, aty ku është e nevojshme, të adresohen në MF përmes planifikimeve adekuate buxhetore, duke siguruar që angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent.</p>	<p>Gjatë vitit 2020 çdo kontratë me shërbime të veçanta paraparakishtë shpallet edhe konkursi.</p>	<p>Dhjetor 2020</p>	<p>Shpend Ahmeti Avni Zuka</p>

		deri në 6 muaj. Nga 9 mostra të testuara, në 5 nga 10, pas përfundimit të kontratave fillestare 6 mujore, ishin nënshkruar kontrata pasuese. Ndërsa në 4 raste, punonjësit ishin angazhuar nga viti në vit. Shkak i aplikimit të kësaj forme të angazhimit të punonjësve është mos aprovimi i kërkesave për pozita të punës me Ligjin e Buxhetit, si dhe nevoja e angazhimit të punonjësve për kryerjen e punëve me kohë të caktuar gjatë viti				
23	C2	Me nenin 39 të LMFP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet, shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Gjatë testimit kemi vërejtur se në 16 raste me vlerë 810,336€, faturat nuk janë paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Shumica e faturave ishin pranuar në vitin 2018. Vonesat kryesisht janë prej 30 ditë deri në 28 muaj përtej afatit të paraparë ligjor. Shkaku i mos pagesave me kohë ishin kontrollat e dobëta në menaxhimin e borxheve dhe menaxhimin e buxhetit.	Kryetari duhet të forcojë kontrollat e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.	Kryetari do të rrisë kontrollin e brendshëm duke shkruar një procedurë kontrolli e cila do të kalojë nëpërmjet drejtores së financave.	Dhjetor 2020	Shpend Ahmeti Valbona Makolli Zekë Bardhaj

Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit.

Komuna e Prishtinës,

KRYETAR I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

Zyra e Kryetarit të Komunës
Tel: +381 (0) 230 900; e-mail: Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UÇK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

		ndonjë defekti nëse paraqitet nevoja. Ne kemi identifikuar se te kontrata "Ndërtimi i rrugës Shaban Koliqi" në Prishtinë me vlerë të kontratës prej 402,097€, nuk ishte ofruar garancioni nga ana e operatorit ekonomik siç ishte paraparë me kontratë. Shkaku i ndodhjes ishte mungesa e mbikëqyrjes nga ana e menaxherit të kontratës.	siç është përcaktuar në kontratë.			
9	A9	Me Vendimin e Kryetarit të Komunës caktohen një menaxher i kontratës dhe organi mbikëqyrës, dy apo tre mbikëqyrës, varësisht prej llojit të kontratës dhe natyrës se për çka është lidhur kontrata. Bazuar në këtë, ne kemi identifikuar se në dy pagesa për projekte kapitale njëra me vlerë 50,000€ dhe tjetra 150,000€ (situacione), zyrtarët e caktuar me vendim të kryetarit të komunës si organ mbikëqyrës nuk kishin nënshkruar në raportin mbi kryerjen e punimeve. Në vend të këtyre janë nënshkruar zyrtarë të tjerë pa ndonjë vendim plotësues të ZKA-së për të justifikuar këtë veprim. Sipas dëshmive të ofruara nga zyrtarët përgjegjës kjo kishte ndodhur pasi zyrtarët që kanë qenë kompetent kishin qenë të angazhuar me punë të tjera	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët e organit mbikëqyrës të emëruar me vendim të kryetarit, janë duke e mbikëqyrur dhe të njëjtit nënshkruajnë raportin mbi kryerjen e punimeve. Në raste të caktuara të bëhet zëvendësimi i tyre me vendime të reja.	Zyrtarët e organit mbikëqyrës të emëruar me vendim të kryetarit, janë duke e mbikëqyrur dhe të njëjtit nënshkruajnë raportin mbi kryerjen e punimeve. Mirëpo, DIKMK do të këtë kujdes që cdo raport për punet e kryera të jetë i nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës të emëruar nga ZKA.	Nëntor 2020	Shpend Ahmeti Gezim Mehmeti Drejtoritë që kanë Menaxher ose mbikëqyrje
10	A10	Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat	Kryetari, duhet të ndërmer masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë	Të gjitha drejtoritë të cilat bëjnë grumbullimin e të hyrave dhe kanë marrëveshje me kompanitë për	Dhjetor 2020	Shpend Ahmeti

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. +381 (0) 230 9000; e-mail. Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

		<p>Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave. Bazuar në PFV dhe shënimeve për të arkëtueshmet ne kemi vërejtur se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë me saldot fillestare, duke mbivlerësuar në PFV këto llogari për 1,525,669€; • Llogarite e arkëtueshme nga të hyrat e lejeve të ndërtimit të prezantuara në PFV në vlerë prej 5,809,125€, janë të nënvlerësuar për 2,185,067€ duke mos i prezantuar në PFV shumat e kësteve që do të paguheshin (arkëtohen) pas vitit 2019; • Në PFV komuna nuk i kishte shpalosur llogaritë e arkëtueshme nga taksa (tarifa) për rregullimin e infrastrukturës, ku këstet e papaguara (që duhet të arkëtohen pas vitit 2019) kapin shumën prej 1,961,987€; Për këto, komuna nuk ka arritur të na ofroj dëshmi për të arsytuar diferencat e paraqitura. 	<p>të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.</p>	<p>kryerjen e pageseve me këste (Garancion) duhet të mbajnë një evidencë për këto marrëveshje ku edhe do të rezultojnë edhe për pjesën e mbetur të marrëveshjes.</p>		<p>Valbona Makolli Ardian Olluri Gëzim Mehmeti</p>
11	A11	<p>Sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Zyrtares Kryesor Administrativ, ndër</p>	<p>Kryetari i Komunës duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u</p>	<p>Kryetari në bashkëpunim me U.D. e Udhëheqësit të NJAB-së do të bejnë një rishikim për cdo dy muaj rreth</p>	<p>Dhjetor 2020</p>	<p>Osman Bllaca</p>

		<p>të tjera, duhet të ndërmerr veprime për përmirësimin e sistemeve në pajtim me rekomandimet e auditimit të brendshëm. Ndërsa udhëzimit administrativ MF- nr. 01/2019 - "Për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik", neni 10, paragrafi 1 thekson se komiteti i auditimit përgatitë raport vjetor për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik i cili përfshin informatat për mënyrën e funksionimit të sistemit të kontrollit. Bazuar në këto, ne kemi vlerësuar se rekomandimet e NJAB nga menaxhmentit i Komunës ishin zbatuar vetëm pjesërisht. Prej gjithsej 31 rekomandimeve të dhëna, 8 ishin zbatuar, 10 ishin në proces të zbatimit dhe 13 nuk ishin zbatuar fare. Këtë e vërteton edhe Raporti vjetor i kësaj njësie që e kishte dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese tek Ministria e Financave. Ndërsa sa i përket raportit të Komiteti i Auditimit nuk na është ofruar gjatë auditimit. Kjo kishte ndodhur për shkak të angazhimit jo të mjaftueshëm nga menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve.</p>	<p>adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.</p>	<p>implementimit të rekomandimeve të NJAB-së për drejtoritë ku kryhet auditimi i brendshëm.</p> <p>Periudhat e rishikimit do të jenë me 30 gusht 2020, 30 tetor 2020 dhe 26 dhjetor 2020.</p>		
12	B1	<p>Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e që kanë ndikuar në opinionin e</p>	<p>Drejtoria për Kulturë do të sigurohet që planifikimi të bëhet sipas rregullave, në mënyrë që të mos ketë keqklasifikim.</p>	Shtator 2020	<p>Shpend Ahmeti Valbona Makolli</p>

	<p>përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë. Siç kemi paraqitur të theksimi i çështjes, gjatë vitit 2019 si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit, shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera totale e tyre ishte 2,502,523€5. Sipas komunës këto janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime, të cilat janë të domosdoshme, andaj edhe si të tilla ishin aprovuar me ligjin e buxhetit. Po ashtu përmes vendimeve gjyqësore (përmbareshve private), janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për paga jubilarë të mësimdhënësve vlera prej 832,262€ ku prej këtyre në emër të tarifave përmbareshve janë paguar 139,489€. Megjithatë, lidhur me këto çështje komuna në PFV evitit 2019 tenehin 6 kishte shpalosur vlerat e këtyre keq klasifikimeve dhe kishte bërë përpjekje që kjo çështje të evitohet.</p>	<p>auditimit. Njëherit, duhet të siguroj që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën, të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike.</p>	<p>Gjatë planifikimit të buxhetit për drejtorinë se Shërbimeve publike janë vlerësuar dhe do vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike. Kjo është bërë dhe do vazhdon të bëhet bazuar në kërkesat e pranuar nga qytetarët dhe vlerësimin në teren nga zyrtarët përkatës të drejtorisë.</p> <p>Menaxhmenti i komunës do t'i ketë parasysh në hartimin e buxhetit për vitin 2021.</p>	<p>Medina Braha Osman Billaca Fatime Hajdari Blërta Basholli</p>
13	<p>B2</p> <p>Në bazë të vendimit të kuvendit komunal, në vitin 2007 ishin dhënë me qira 21 banesa për ish këshilltarët komunal. Ndërsa, me vendimin e komisionit për çështje banesore në vitin 2008 ishin dhënë edhe 22</p>	<p>Kryetari, duhet të merr masa të shpejta në procesin e shqyrtimit të kësaj çështje për të sanuar situatën aktuale, përmes përpilimit të kontratave të reja apo dhe</p>	<p>Kryetari do të shikoj se çfarë përmbajnë kontratat e mëparshme dhe se bashku me drejtorin e pronës të evidentojnë hapat e mundshëm për zgjidhjen e këtij problemi.</p>	<p>Dhjetor 2020</p> <p>Shpend Ahmeti Brahim Mehmetaj</p>

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. +381 (0) 230 900; e-mail. Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

		<p>banesa tjera me qira për punëtorë administrativ. Prej tyre, ne kemi testuar katër raste dhe kemi gjetur se këto kontrata kanë skaduar dhe të njëjtat nuk janë vazhduar më. Qiramarrësit vazhdojnë të shfrytëzojnë banesat. Përveç kësaj edhe pse kompensimi ishte minimal pagesa e qirasë nuk ishte bërë në kohë të rregullt dhe figuronin borxhe në vlerë 15,874€ kurse një qiramarrës edhe pse me kontratë të skaduar ka bërë pagesën prej 297€. Edhe përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, menaxhmenti ende nuk kishte ndërmarr masa, dhe se aktualisht sipas tyre ishin në proces të evidentimit të gjendjes aktuale të këtyre pronave që më pas të trajtohen sipas ligjit.</p>	<p>formave tjera ligjore që qojnë drejt arkëtimit e të hyrave për komunën dhe përdorimin legjitim të pronave.</p>			
14	B3	<p>Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale 03-L040 neni 14, Statutit të komunës neni 33.2- a, dhe Ligjit 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës vihet në pah mundësia/mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale. Në vitin 2014 komuna kishte bërë verifikimin e të gjitha pronave komunale, në mesin e të cilave edhe ngastrat që janë në pjesën e quajtur "Zona Industriale". Të paktën 37 parcela të kësaj zone me rreth 6 hektarë, shfrytëzohen nga biznese të ndryshme pa asnjë kompensim ndaj komunës. Kjo</p>	<p>Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore</p>	<p>Kryetari do të shikoj se çfarë përmbajnë kontratat e mëparshme dhe se bashku me drejtorin e pronës të evidentojnë hapat e mundshëm për zgjidhjen e këtij problemi.</p>	Dhjetor 2020	<p>Shpend Ahmeti Brahim Mehmetaj</p>

		<p>çështje është ngritur edhe në raportin e vitit të kaluar dhe vazhdon të mbetet e pazgjidhur. Megjithatë, nga komuna nuk është ofruar ndonjë shpjegim konkret se pse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ta adresuar këtë çështje. Sipas kalkulimit të thjeshtë krahasuar me qiratë tjera i bie që komuna humb së paku 6C/m2 apo 360,000C/muaj.</p>				
15	B4	<p>Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, Nr 110-2782, parasheh ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste në komunë. Drejtoria e Planifikimit Strategjik, e cila është e ngarkuar me këtë çështje nuk ka informata për numrin e veprimtarive afariste që janë të obliguara të paguajnë taksën komunale. Të hyrat nga kjo taksë mbështelen në deklarimin vullnetar të bizneseve, ngase atyre nuk iu lëshohet paraprakisht faturë. Në këtë vit, nga kjo taksë janë mbledhur 49,750C, për dallim që vitin e kaluar ishin mbledhur 63,227C. Shkak i kësaj ishte mungesa e një baze të të dhënave për bizneset që operojnë në komunë..</p>	<p>Kryetari, të ndërmarrë masa rreth krijimit të një baze të saktë për të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal. Më tutje të sigurojë se bizneset faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.</p>	<p>Në mënyrë që Komuna e Prishtines të informohet ne menyre te sakt per numrin e bizneseve te cilat operojnë ne Komunën e Prishtines duhet te nënshkruhen marrveshje bashkëpunimi me ARBK-ne apo ATK-ne qe përmes sitemit ne kohe rekord te njoftohen se cilat biznese regjistrohen dhe cilat shuajn aktivitetin e veprimtarisë se tyre. Ne kete form Komuna e Prishtines do te kete shume te leht t'i evidentoje bizeset qe operojn ne territorin e komunës dhe t'i ngarkon bizeset me takse.</p>	Dhjetor 2020	Genç Bashota
16	B5	<p>Sipas kushteve të veçanta të kontratës "Ndërtimi i kolektorit mbi lumin Prishtina" parashihej që plani dinamik për realizmin e këtij projekti të jetë 120 ditë. Për këtë projekt, kontrata ishte nënshkruar</p>	<p>Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se</p>	<p>Në bazë të ndryshimeve ligjore nga MF cdo planifikim i projeteve për investime kapitale duhet të përfshihet shepenzimet e shpronësimeve dhe të gjitha shpenzimet tjera operative të atij</p>	Mars 2021	Shpend Ahmeti

		me datën 09.08.2016 në vlerë 2,192,854€, ndërsa ishin realizuar punë në vlerë prej 1,940,750€ ose 88%. Si e tillë, kontrata ishte mbyllur më datën 13.12.2019. Arsye për se nuk është përmbushur kontrata ishin problemet pronësore që lidhen me këtë projekt në linjën ku zhvillohet kanalizimi fekal i cili nuk është përfunduar komplet. Shkaku i kësaj është fillimi i realizimit të projekteve pa e kryer paraprakisht procesin e shpronësimit.	para inicimit të tyre, të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe ato të realizohen sipas planit dinamik.	projekti. Në bazë të këtyre ndryshimeve ligjore besojmë që do të eliminohet kjo e gjetur.		
17	B6	Komisiioneve Vlerësuese të Tenderëve paragrafi 40.5 thekson se komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë relevante me kërkesat e prokurimit. Po ashtu në dy dosje të tenderit ishin përcaktuar kërkesat apo dokumentet që ofertuesit do të duhej të plotësonin. Lidhur me këto, ne kemi vërejtur si në vijim: • Te kontrata "Furnizim me triopod, projektor dhe drona në vlerë 11,652€, kemi vërejtur se anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk ishin me përvojën relevante siç kërkohet me udhëzuesin e prokurimit. Më tutje, operatori ekonomik fitues kishte sjellë certifikata të ISO standardeve në të cilat nuk figuron emri i operatorit ekonomik, siç ishte kërkuar për produktet ISO 19001:2008 dhe ISO 240001:2004 në dosje të tenderit; dhe • Te kontrata "Furnizimi me inventarë kuzhine	Kryetari duhet të shtoj kontrollat tek vlerësimi i ofertave në mënyrë që të respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, si dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të jenë njerëz kompetente me njohuritë e fushës përkatëse.	Bazuar në stafin që është në dispozicion, bëhet përpjekje maksimale që anëtarët e propozuar të komisionit të vlerësimit të dërgohen sipas kompetencave dhe njohurive të fushës përkatëse, duke mos i dërguar të njëjtit që kanë përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose kanë përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura. Është bërë edhe kërkesë për rekrutim të profileve që mungojnë krahasuar me punët që realizohen dhe fushat që mbuloohen nga shërbimet e DSHP-së.	Dhjetor 2020	Shpend Ahmeti Zyra e Prokurimit Drejtoritë që kanë kontratë me OE

		<p>dhe pajisje tjera për çerdhen Yllkat dhe çerdhen Kalabria në vlerë 66,451€, kemi vërejtur se operatori ekonomik fitues nuk i kishte në dosje të gjitha referencat e kërkuara të kontratave për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit me vlerë jo më pak se 40,000€, si dhe referencat e bashkëngjitura ose certifikatat e kryerjes së furnizimeve. Kjo ka ndodhur në mungesë të komunikimit mes drejtorive për caktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit, si dhe komisionet e vlerësimit të ofertave nuk i kanë kryer punët sipas kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit.</p>				
18	B7	<p>Sipas Rregullës Financiare 01/2013, procesit për iniciimin e shpenzimit, i paraprin kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, urdhër-blerja, pranimi i mallit dhe më pas fatura. Nga 198 pagesa të testuara, në 74 prej tyre, që kishin të bënin me investime kapitale dhe mallra e shërbime, nuk janë respektuar rregullat e lartcekura. Urdhër-blerja dhe zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimi të punëve/ furnizimeve, gjegjësisht pas pranimi të faturës. Ne po i theksojmë vetëm dy raste me detaje:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në kontratën "Furnizim me makina (mikser) për përgatitjen e ushqimit të koncentruar për bagëti LOT 3", në vlerë 25,200€, zotimi i mjeteve në SIMFK ishte bërë me 5 	<p>Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e iniciimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhër-blerjes.</p>	<p>Udheheqesi i Prokurimit do të perpiqet që në çdo kontratë të perpiluar nga zyrtarët e prokurimit të shenohet vlera e mjeteve të zotuar dhe obligimi i menaxherit të kontratës që për realizimin e pjesës së kontratës (pa zotim të mjeteve)se pari të paraqes kerkese per zotim te ri nga Drejtoria e Financave</p>	Mars 2021	<p>Valbona Maqolli Zekë Bardhaj</p>

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. +381 (0) 230 9000, e-mail: Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së, kati i -te, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

		muaj vonesë; dhe • Në kontratën kornizë "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Brigadës së zjarrfikësve, në vlerë totale indikativë prej 242,717€, vetëm një pjese e vogël e zotimit ishte bërë një muaj pas nënshkrimit të kontratës. Shkaku i ndodhjes së kësaj, është mungesa e komunikimit të mirë mes palëve kompetente.				
19	B8	Sipas Rregullores Nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Kryetari duhet të themeloj një Komision për inventarizimin e pasurisë me qëllim të inventarizimit vjetor apo periodik të pasurisë jo financiare. Ky proces duhet të paraprij përgatitjes së PFV. Gjatë vitit 2019 nuk ishte bërë, pasi që kryetari nuk kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurisë.	Kryetari të caktoj komisionin për inventarizim të pasurisë në mënyrë që të ketë informata të sakta vjetore apo periodike rreth gjendjes së secilës pasuri jo financiare.	Kryetari do të caktojë komisioni për inventarizim në nivel të përgjithshëm të komunës.	Nentor-Dhjetor 2020	Shpend Ahmeti Vasilika Zotaj Valbona Makolli
20	B9	Sipas Rregullores Nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 6 dhe 10 përcaktojnë që, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrat e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj (SIMFK dhe e-pasuri) dhe të gjitha pasuritë jo financiare, pas pranimin duhet të regjistrohen në regjistra kontabël pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara. Edhe përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, gjendja është si në vijim: • Moduli e-Pasuria nuk përdoret, është jofunksional për arsye se kanë	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të njafueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.	Sa i përket sistemit e-Pasuria për menaxhimin e pasurive jo kapitale ose nën 1,000.00 €, konfirmoj se kam bashkëpunuar me zyrën e IT gje që njëri nga zyrtarët e IT ka dorzuar kërkesën në zyrat e Prokurimit për blerje të një aparati për printimin e barcodave respektivisht leximin e tyre gjat pranimin/rexhistrimit të pasurive nën 1,000.00€. Gjithashtu ju njoftoj se kemi provuar të bartim të gjitha të dhënat e grumbulluara për pasuritë nën 1,000.00 € dhe të migrohen direkt në	Dhjetor 2020	Shpend Ahmeti Valbona Makolli Bujar Gashi Shpresa Shala Bedri Rashica Brahim Mehmetaj

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. + 381 (0) 230 900; e-mail: Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

	<p>probleme nga ana e ministrisë për këtë softuer. Të dhënat për pasuritë nën 1,000€ mbahen në data bazë të brendshme të komunës në formë të Excel-it, megjithatë ky aplikacion mund të paraqet rrezik të përhershëm për lëshim gabimesh, shlyerje, etj. Për këtë çështje komuna kishte bërë kërkesë në MAP për ta rregulluar këtë, mirëpo ministria nuk kishte bërë asgjë në lidhje me këtë; dhe • Vazhdojnë edhe më tutje të mbesin të paregjistruara objektet: 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim; ish-objekti i gjykatës së Apelit; ishobjekti i gjykatës komunale; ndërtesa ku ndodhet drejtoria e inspeksionit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, edhe toka e shpronësuar për interes, nuk figuron si pasuri e komunës. Sipas zyrtarëve nga komuna, pritet që gjatë vitit 2020 zyrtarët që menaxhojnë me këtë sistem të ja përcjellim tabelën e migrimit me të dhënat e plotësuara dhe të fillojnë me aplikimin e regjistrimit të pasurive jo kapitale në sistemin e-Pasuria për vitin 2019. Ndërsa për regjistrimin e objekteve të cilat janë në pronësi të komunës theksojnë se duhet të formohet një komision profesional për ti vlerësuar fillimisht pastaj të regjistruhen në regjistra.</p>		<p>sistemin e-Pasuria, por nga zyrtarët e MAP-it na është konfirmuar se një gjë e tillë është e pamundur përshkak që versioni i ri i sistemit në fjalë nuk e pranon tabelën, sepse tabela e dërguar tek ne është nga versioni i vjetër i sistemit e-Pasuria, gjë që ky sistem për momentin nuk është duke funksionuar në Komunën e Prishtinës.</p> <p>Ndërsa sa i përket rexhistrimit të 43 objekteve e që janë pronë e Komunës së Prishtinës në ditët në vazhdim do takohemi me zyrtarët e departamentit të Tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave dhe ta shqyrtojmë mundësin që vlerësuesit e këtij departamenti ti vlerësojnë pronat (objektet) në fjalë. Atëher me të përfunduar vlersimi i tyre, ne si Komunë e Prishtinës (pronar) të kësaj pasurie do i rexhistrojmë në sistemin e FreeBalancit.</p>		
21	B10 Përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, komuna nuk po arrin të krijoj	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për	Komisioni për mbeturina vazhdimisht përditëson dhe do	Mars 2021	Shpend Ahmeti

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. + 381 (0) 230 900, e-mail: Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
 Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
 10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës

Komuna e Prishtinës,

Datë 15..07.2019



KRYETAR I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

Zyra e Kryetarit të Komunës
Tel - 381 (0) 230 900; e-mail - Shpend.Ahmeti@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Komunës së katit të ndërtës së vjetër, rruga UCK
10 000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës